

Miratohet _____
Ministri i Shendetesise
Kryetari i KMR

MINISTRIA E SHENDETESISE
KOMISIONI I MBROJTJES NGA RREZATIMET
Rregullore e
Komisionit te Mbrojtjes nga Rrezatimet

Nr.3072/2prot

Date 10.08.2009

MINISTRIA E SHENDETESISE
KOMISIONI I MBROJTJES NGA RREZATIMET

Rregullore e

Komisionit te Mbrojtjes nga Rrezatimet

1.Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet (KMR) eshte ngritur mbi bazen e ligjit 8024 date 9/11/1995 « Mbi Mbrojtjen nga Rrezatimet Jonizuese »

2.Detyra. KMR i ka percaktuar detyrat si me poshte nga Ligji « Per Mbrojtjen nga Rrezatimet Jonizuese » neni 7

Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet ka keto detyra e te drejta :

- a) Nxjerr rregulloret, udhezimet dhe aktet e praktikave te mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese dhe sigurine berthamore, te cilat jane te detyrueshme per zbatim nga te gjithë personat fizike e juridike
- b) Kontrollon zbatimin e akteve ligjore e nenligjore mbi mbrojtjen nga rrezatimi.
- c) Pajis me licence subjektet qe kryejne veprimtarite e parashikuara ne nenin 3 te ketij ligji.
- d) Drejton nga ana teknike te gjitha autoritetet kombetare dhe lokale per zbatimin e menjehershëm te masave te njevojshme per zbutjen e efekteve te aksidenteve berthamore.
- f) Ben rekomandime dhe propozime per permiresimin e legjislacionit ne fuqi ne fushen e mbrojtjes nga rrezatimet
- g) Miraton standartet e sigurise per mbrojtjen nga rrezatimet .
- gj) Bashkepunon me organizmat kombetare per problemet e mbrojtjes nga rrezatimet.
- i) Angazhon institucionet kerkimore – shkencore ne te gjithë vendin per zgjidhjen e problemeve ne fushen e mbrojtjes nga rrezatimet .
- j) Percakton strukturen organizative te Zyres se Mbrojtjes nga Rrezatimet , si dhe emerone dhe shkarkon drejtuesin e saj .
- k) Bashkepunon me Inspektorin Shteteror te Punes.

KMR ne baze te ligjit miraton rregulloret mbi:

- a) Procedurat e licencimit per veprimtarite e parashikuara ne nenin 3 te ketij ligji.
- b) Mbrojtjen epopullates dhe te mjedisit nga rrezatimet jonizuese.
- c) Mbrojtjen e personave te ekspozuar profesionalisht ndaj rrezatimeve.
- d) Standartet dhe aktet praktike te veprimtarive me burime rrezatimi.
- dh) Masat e sigurimit per lendet , pajisjet dhe instalimet rrezatuese.
- e) Veprimtarite e zyres se mbrojtjes nga rrezatimet.

3.Antaret e KMR .Ne baze te nenit 6 te ligjit Komisioni kryesohet nga Ministri i Shendetesise te pakten 50 per qind e anetareve te tij jane specialiste te mbrojtjes nga rrezatimet . Anetaret e KMR emerohen nga kryetari per nje afat 4vjecar . Antaret marrin pjese ne mbledhjet e KMR , japim mendime dhe votojne per çeshjet qe trajtohen ne mbledhje.

4. Mandati. Mbledhja e pare e KMR duhet te thirret jo me vone se 45 dite nga dita e miratimit te anetareve te KMR .Ne kete dite KMR zgjedh protokolluesen e Komisionit e cila mban proces verbalin e KMR .

5. Kryetari. Kryetari i KMR caktohet ne baze te nenit 6 te ligjit dhe eshte Ministri i Shendetesise
6. Sekretari. Bazuar ne ligj Neni 6 Sekretari i KMR eshte dhe Kryetar i ZMR . Me propozim te Kryetarit , KMR emerohet dhe shpallhet Sekretari i KMR dhe njekohesisht Kryetarin e ZMR , sipas procedurave te votimit te kesaj Rregulloreje. Mandati i tij eshte i ndare nga ai i anetareve te tjere te KMR.
7. Drejtimi i mbledhjeve. Kryetari drejton mbledhjet e KMR . Ne mungese te tij Kryetari cakton Sekretarin te drejtoje mbledhjen .
8. Mbledhjet e KMR . Bazuar ne Ligjin e mesiperme neni 8 pika (dh) KMR mbledhet sipas nevojave dhe dokumentacionit qe eshte per tu shqyrtuar nga KMR me propozim te sekretarit tek Kryetari. Ne raste te vecanta , KMR mbledhet me kerkese te Kryetarit te KMR , ose nje te tretes se antareve. KMR mund te mbaje mbledhje te hapura ose te mbyllura. Ne mungese te nje vendimi mbledhjet mbahen te mbyllura.
9. Rendi i dites. Prcaktohet nga Sekretari i KMR , i cili perpilohet ne varesi te situates dhe kerkesave qe mund te paraqiten.
10. Njoftimi per mbledhje. Njoftimi per mbledhjet e Keshillit kryhet nga sekretari . Çdo anetar i Keshillit duhet te njoftohet te pakten nje jave para mbledhjes, per rendin e dites, daten, oren dhe vendin.
11. Vendimet e KMR merren me consensus . Kur ky consensus nuk arrihet vendimet merren me 2/3 e votave te anetareve te pranishem ne Mbledhje te KMR . Nqs perseri nuk arrihet te merret vendimi ne kete rast vendimi merret me 50 % + 1 te votave .
12. E drejta e votes. Çdo antar i KMR ka te drejten e nje vote.
13. Mbajtja e Mbledhjes .Mbajtja e mbledhjes behet kur ne te marrin pjese me shume se 50% e anetareve te KMR
14. Dokumentacioni i mbledhjeve. Gjate mbledhjeve te KMR mbahet proces-verbal nga protokolluesja e KMR . Permbledhja e dokumentacionit te mbledhjeve pergatitet nga personi i ngarkuar per process verbalin dhe sekretaria. Mbas miratimit nga Kryetari, materiali u shperndahet institucioneve te interesuara .
15. Pagesa e antareve. Per mbledhjet e KMR menyra e shperblimit te anetareve caktohet nga Ministri i Shendetesise.
16. Ndryshimi i Rregullores. Pikat e kesaj Rregullore mund te ndryshohen me ane te nje vendimi te KMR sipas pikes 11 te kesaj rregulloreje.
17. Miratimi i Rregullores. Miratimi i kesaj Rregullore behet nga KMR sipas pikes 11 te saj.